

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI  
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR  
“BEST DATA” SH.P.K**

**Neni 1**

**Emërtimi dhe ortakët e Shoqërisë**

Sot, në Tiranë, në datën **30.07.2024** me vullnetin e lirë ortaku :

**Z.Gëzim Mançë**, shtetas shqiptar i datëlindjes **24.10.1961**, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, Shqipëri, pajisur me Nr.Personal **G11024050D**.

**Vendosi**: Të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar emërtimi i së cilës do të jetë “**BEST DATA**” SH.P.K , më poshtë e quajtur si “Shoqëria”.

**Neni 2**

**Selia e Shoqërisë**

Shoqëria do ta ketë selinë e saj me Apartament me nr. Pasurie 301/198+2-3,ZK 3866, vol.65, fq.52,Yzberisht, Tiranë.

**Neni 3**

**Kohëzgjatja e Veprimtarisë**

Kohëzgjatja e veprimtarisë do të jetë me një afat të papërcaktuar që fillon në datën 30.07.2024.

**Neni 4**

**Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 500.000 (pesëqind mijë lekë), e cila përfaqëson 100% të kapitalit.

Ortaku i vetëm **Gëzim Mançë zotëron 100% të kapitalit**, e cila perfaqëson një kuotë të vetme me vlerë 500.000 lekë, i cili është tërësisht kapital financiar që përbëhet nga kontributi i ortakëve të kompanisë.



Ortaku ka të drejtë ta tjetërsojë këtë kapital, të shtojë apo të pakësojë kuotat e kapitalit deri në kufijtë e përcaktuara nga ligji.

Secili ortak disponon një kuotë në Shoqëri. Asnjë nga ortakët nuk mund të transferojë kuotën përkatëse të pjesëmarrjes në Shoqëri pa miratimin paraprak me shkrim të ortakëve të tjerë. Në rast se një nga orakët dëshiron të kalojë/transferojë plotësisht apo pjesërisht kuotën e tij në Shoqëri, duhet t'ia ofrojë këtë kuotë për blerje ortakëve të Shoqërisë. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga ofrimi i kuotës për blerje, ortakët do të kenë të drejtën të blejnë kuotën e ofruar në shitje sipas çmimit dhe mënyrave të pagesës për të cilat kanë rënë dakord me ortakun shitës.

Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë ortakët do të kenë të drejtë me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.

### **Neni 5**

#### **Objekti i Veprimtarisë**

##### **Objekti i veprimtarisë së kesaj Shoqërie do të jetë:**

Shërbime marketing, dizajn, publicitet, konsulencë, përfaqësim për të tretë etj.

### **Neni 6**

#### **Kalimi i kuotave me trashëgimi (Mortis Causa) ose për shkak të Falimentimit të ortakut**

Në rast vdekje apo falimenti të njërit prej ortakëve, kalimi i kuotës dhe i të drejtave përkatëse në favor të trashëgimtarëve apo personave që fitojnë këto të drejta duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme, e cila duhet të shprehet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i vdekjes apo i falminetimit të ortakut. Në rast të refuzimit të pëlqimit apo nëse Asambleja e Përgjithshme nuk është shprehur brenda afatit të sipërpërmendur, Shoqëria do t'ju paguajë trashëgimtarëve apo perosnave që fitojnë këto të drejta vlerën e kuotës që do të përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme, duke patur parasysh gjendjen pasurore të Shoqërisë dhe vlerën e tregut të kuotës.

Personi që fiton të drejtën mbi kuotën e pjesëmarrjes për shkak të vdekjes apo falimentimit të një ortaku mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë



regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të zgjedhur orej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton Shoqërinë në lidhje me këtë vendim.

Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë për shkak të vdekjes apo falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit si zotërues i kuotës.

### **Neni 7**

#### **Zmadhimi i Kapitalit**

Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur, nese nuk janë të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi zmadhimin e kapitalit.

Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjestim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panënshkruar prej tyre mund të nënshkruhet nga ortakët e tjera. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë sërisht të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjestim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

### **Neni 8**

#### **Zvogëlimi i Kapitalit**

Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.

Ortakët epërballojnë zvogëlimin e kapitalit të shoqërise, në përpjetim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

### **Neni 9**

#### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

Asambleja e përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilar është kompetente sipas ligjeve



në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akti Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asmablesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zoteron në Shoqëri.

Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjeter ose nga një person tjeter, me prokurë më shkrim.

Mbledhja e Asmablesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë ne mbledhjen e Asmablesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike (conference call) audio ose video, në përputhje me ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe ligjin për Komunikimet elektronike. Mbledhja e Asmablesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartojet dhe të nënshkurhet procesverbali përkatës.

Asambleja e përgjithshme mund të thirret nga Administratorët ose nga ortakët në baze të nenit 84 të ligjit nr .9901 datë 14.04.2008 “Mbi ndërrmarrjet dhe Shoqëritë Tregtare”. Thirja e mbledhjes së Asmablesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektornike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara Shoqërisë të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbaje rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.

Asambleja e përgjithshme do të mblidhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, kur ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord të vendosin në lidhje me rendin e ditës.

Mbledhjet e Asmablesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratorët. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje ndër personat e pranishëm.

Vendimet e Asmablesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.

Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit finanziar.

Asambleja e Përgjithshme, përvecse për sa parashikon neni 9 i këtij Akti themelimi dhe Statuti, për vendime që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët më të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që



Viti finansiar i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe mbaron në 31 Dhjetor të çdo viti.

**Neni 13**

**Kontrolli Financiar**

Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Autorizuar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo me shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në atë rast kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërcohët në bazë të ligjit.

**Neni 14**

**Bilanci Vjetor**

Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit administrativ mbi securinë e veprimtarisë sociale dhe të ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

**Neni 15**

**Dividentët**

Në përputhje me dispozitat ligjore, Asambleja e Përgjithshme vendos mbi shpërndarjen e dividentëve në bazë të rezultatit financiar të shoqërise.

**Neni 16**

**Gjuha**

Ky Akt Themelimi u nënshkrua në **2 (dy)** kopje në gjuhën shqipe.

**Neni 17**

**Dispozita përfundimtare**

Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj me këtë Akt Themelimi dhe Statut dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për sa nuk parashikohet në këtë Akt



zotërojnë më shumë se 30 % (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, sipas nenit 86 pika I, të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare”.

**Neni 10**  
**Administratori**

Shoqëria do të administrohet dhe përfaqësohet nga një Administrator për një kohëzgjatje prej **5 vjetësh** për periudhën **30.07.2024 deri 30.07.2029**, i cili do të jetë, **Ahmet Berzani**, i datëlindjes **08.07.1990**, lindur në **Përmet**, Shqipëri i pajisur me letërnjoftim me Nr.Personal **J00708031H**, dhe me banim në **Tiranë**.

Administratori zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë, përveç veprimeve, përbushja e të cilëve i rezervohet Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të Shoqërisë. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë dhe mund të autorizojë persona të tretë, për të përbushur veprime të caktuara, në emër dhe për llogari të Shoqërisë. Në çdo rast administratori do të jetë përgjegjës për veprimet e të tretëve të autorizuar.

Asambleja e përgjithshme vendos shpërblimin e administratorëve te Shoqërisë.

**Neni 11**  
**Shpërbërja dhe likuidimi**

Shoqëria shpërbëhet për arsyet e parashikuara nga ligji dhe me:

- a. Për mbarimin e afatit.
- b. Për pamundësi të funksionimit ose për inaktivitetin të vazhduar të asamblesë,
- c. Për reduktimin e kapitalit nën minimumin ligjore.
- d. Me vendim të asamblesë e për arsyet e tjera të parashikuara me ligj

Në të gjitha hipotezat e shpërbërjes, asambleja e ortakëve, do të caktojë një ose më shume likuidatorë duke percaktuar numrin e likujdusve si dhe kriteret në bazë të të cilave do kryhet likuidimi.

**Neni 12**  
**Viti Financiar**



themeli dhe Statut, do të zbatohen parashikimet e ligjit nr.9901 i datës 14.04.2008  
“Mbi ndërmarrjet dhe Shoqëritet tregtare”.

**Ortaku**

Gëzim Mançë

GEZIM MANÇË

